



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602290/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda: **Rekomandim për marrjen e masave për vaksinimin e fëmijëve të shtetasve me incialet M. Gj.,**

Drejtuar: Qendra Shëndetësore

Kukës

Për dijëni: **Z. Ilir Beqja**
Minister i Shëndetësisë

Z. Arjan Bregu
Drejtor i Institutit i Shëndetit Publike

Tiranë

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është dorëzuar ankesa e shtetasve H. M., me banim në Kukës e cila ankohet se Qendra Shëndetësore, Kukës nuk kanë lejuar vaksinimin e fëmijëve të shtetasve M. Gj., vajza e ankueses së lartpërmendur me pretendimin që vajza e saj bashkëjeton me një shtetas kosovar dhe vaksinimin e fëmijëve duhet ta realizojë në Kosovë pavarësisht se fëmijët jetojnë në Kukës.

Në mbështetje të nenit 16 të Kushtetutës ku parashikohet se "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë" si dhe në zbatim të shkronjës c), të nenit 59, të Kushtetutës ku parashikohet "standardi më i lartë shëndetësor, fizik e mendor, i mundshëm" si dhe shkronjës a) dhe i) të pikës 7 të ligjit Nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve

infective” çdo fëmijë, gëzon të drejtën për tu vaksinuar, pavarësisht problematikës së pretenduar nga Qendra Shëndetësore Kukës.

Për sa më sipër si dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të menjëhershme për vaksinimin e fëmijëve të shtetas M. Gj., me banim në Kukës nga Qendra Shëndetësore e këtij qyteti.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brënda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI